



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna -Municipality
Hani i Elezit



**RREGULLORJA PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË NË KOMUNË
E HANIT TË ELEZIT**

Nëntor 2015



**Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna -Municipality
Hani i Elezit**

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.11.2015 miratoi Plotësim-Ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentë në Komunën e Hanit të Elezit.

RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për aplikim, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfituesve të bursave, formimi i komisionit dhe e drejta e ankesës.

II. SIGURIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE

Neni 2

- 2.1. Mjetet për bursa sigurohen nga buxheti i Komunës së Hanit të Elezit dhe nga donatorët.
- 2.2. Financimi nga donatorët ndahet sipas kriterëve të rregullores

Neni 3

- 3.1. Kuvendi i Komunës në bazë të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës dhe eventual të ndonjë donatori vullnetar për ç' do vit cakton numrin dhe shumën e bursës dhe cakton drejtimit prioritar.
- 3.2. Për bursë kanë prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas Nenit 7 pika 7.3.

Neni 4

- 4.1. Një student nuk ka të drejtë të marrë dy apo më shumë bursa nga njësitë buxhetore apo burime të ndryshme, përjashtim ka për ato studentë që marrin bursë universitare.
- 4.2. Nëse vërtetohet se studenti që është përfitues i bursës nga komuna është duke marrë bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore ai obligohet ta kthejë bursën e komunës.
- 4.3. Studenti nëse është në mardhënje pune nuk i takon bursa.

Neni 5

5.1. Studentët që i takojnë të njejtës familje që plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës prioritet ka vetëm njëri, studenti që ka notë mesatare më të lartë.

III. KUSHTET PËR APLIKIM

Neni 6

Të drejtë për të aplikuar për bursë kanë të gjithë studentët të cilët:

- a) janë banorë rezidentë të Komunës së Hanit të Elezit,
- b) janë student të rregullt, por jo me vet financim,
- c) të kenë të regjistruar vitin.
- d) Studenti nëse një herë ka perseritur vitin, humbë të drejtën e bursës
- e) të jetë student i Universitetit Publik të Kosovës.
- f) Studenti i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë.
- g) Studenti nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursës.

IV. KRITERET PËR PËRZGJEDHËJE

Neni 7

7.1 Fëmijëve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së iu ndahet bursa pa kritere.

7.2 Vlerësimi kandidatëve bëhet me pikë, duke e shumëzuar notën mesatare me koeficientin 5.

7.3 Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë dhe numri i pikëve të testit të arritshmërisë (afati i Qershorit dhe Gushtit) dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës.

7.4. Përveç pikëve nga paragrafi paraprak , studentëve që u takojnë kategorive të veçanta u shtohen pikë si në vijim:

- a) fëmijës së invalidit të luftës i shtohen 20 pikë.
- b) studenti i cili nuk i ka të dy prindërit i shtohen 20 pikë.
- c) studenti i cili ka të dy prindërit me nevoja të veçanta i shtohen 20 pikë.
- d) fëmijës së veteranit të luftës i shtohen 15 pikë.
- e) fëmijës së të burgosurit politikë i shtohen 15 pikë
- f) studenti i cili është me nevoja të veçanta i shtohen 20 pikë
- g) fëmijës së martirit të luftës i shtohen 10 pikë
- h) studenti i cili ka njërin prind me nevoja të veçanta i shtohen 10 pikë
- i) studenti i cili e ka gjendjen e rëndë sociale i shtohen 15 pikë
- j) studenti me gjendje të rëndë ekonomike që me ligj largohen nga skema sociale për shkak se nuk kanë fëmijë nën moshën pesë vjeçare të u jepet përparësi njëjtë sikur se te rastet sociale i shtohen 15 pikë.
- k) studenti i cili nuk e ka njërin prind 10 pikë
- l) familja bërthamë që ka dy e më tepër student në fakultetin publikë i shtohen 10 pikë,
- m) studenti me notë mesatare 9 e mbi, vlerësohet me 10 pikë
- n) studenti me notë mesatare 8 e mbi, vlerësohet me 5 pikë,

- o) studenti me notë mesatare 7 e mbi , vlerësohet me 3 pikë,
- p) studenti i cili bënë punë vullnetare vlerësohet me 5 pikë.
- q) studenti që ka marrë diploma, mirënjohje, certifikata kombëtare ose ndërkombëtare në ndonjë garë – konkurs në lëmin arsimore i shtohen 3 pikë.
- r) tu jepet përparësi studentëve të cilët janë kuadra deficitare.

V. KONKURSI

Neni 8

8.1. Bursat ndahen në bazë të konkursit publik.

8.2. Drejtoria e arsimit bënë shpalljen e konkursit publik në tabelën e publikimeve pranë Komunës së Hanit të Elezit, në Web faqen e komunës dhe në median lokale nëse ka.

8.3. Konkursi duhet të përmbajë:

- a) kushtet për konkurrim.
- b) shumën e bursës për një vit kalendarik.
- c) dokumentet e nevojshme për konkurrim.
- d) profilet prioritare.
- e) afati për aplikim është 15 ditë kalendarike.

Neni 9

9.1. Marrja dhe dorëzimi aplikacioneve bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës.

9.2. Zyrtari që bënë pranimin e aplikacioneve duhet :

- a) të kontrolloj dokumentet e aplikimit nëse janë apo nuk janë të kompletuara,
- b) të regjistroj dokumentet që i bashkëngjiten aplikacionit,
- c) të vërtetoj a është fotokopja e indeksit identike me origjinalin.

Neni 10

10.1. Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- a) certifikata e provimeve të dhëna së bashku me fotokopjen e ID-së.
- b) deklaratat e bashkësisë familjare.
- c) dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale.
- d) certifikatën e vendbanimit,
- e) diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor.

10.2. Studentët që janë invalid të luftës, anëtar të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirit të luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuar duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse.

VI. FORMIMI I KOMISIONIT

Neni 11

- 11.1. Drejtoria e Arsimit për çdo vit formon komisionin për ndarjen e bursave prej 3 anëtarëve.
- 11.2. Komisioni zgjedh kryetarin e saj që udhëheq me punën e komisionit dhe nënshkruan vendimet e komisionit për ndarjen e bursave.
- 11.3. Detyrat e komisionit janë :

- a) të verifikoj afatshmërinë e aplikacioneve dhe kompletimin e tyre me dokumentet e kërkuara,
- b) të bëjë vlerësimin me pikë të aplikuesve sipas kritereve të parapara në këtë rregullore dhe përpilon listën prioritare,
- c) të publikoj në afat prej 3 ditë pune vendimin me emrat e përfituesve të bursës në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të komunës, pas miratimit nga Drejtori i DKA-së.

VII. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 12

- 12.1. Kundër vendimit të komisionit mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit për përfituesit e bursës drejtuar komisionit për ankesa dhe parashtrës të Komunës së Hanit të Elezit.
- 12.2. Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

- 13.1. Kjo rregullore miratohet nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit sipas procedurave për miratimin e akteve normative.
- 13.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas procedurave për miratimin e akteve normative.
- 13.3. Për zbatimin e kësaj rregullore, përgjegjës është Drejtoria për Arsimi, Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Hanit të Elezit.

Hyrja në fuqi

Neni 14

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Hani i Elezit
Data: 26.11.2015

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Braya

